

PRISHTINA



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA
1

**DREJTORATI I SHËRBIMEVE PUBLIKE, I TRANSPORTIT,
I MBROJTJES SË AMBIENTIT DHE I TOKËS NDËRTIMORE**

PROJEKT

**V E N D I M
P Ë R
PLOTËSIMIN E RREGULLORES
PËR TARIFA DHE NGARKESA KOMUNALE**

Prishtinë, qershor 2005

PRISHTINA



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 39.1 të Rregullorës së UNMIK-ut 2000/45, Udhëzimi administrativ nr.2001/2 dhe 2001/3, nenit 19, paragrafi 4 dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më _____ 2005, miratoi këtë

V E N D I M
PËR PLOTËSIMIN E RREGULLORES
PËR TARIFA DHE NGARKESA KOMUNALE

Neni 1

Në Rregulloren për tarifa dhe ngarkesa komunale 01 nr. 413-523, të datës 02.04.2002, në pjesën “Pasqyra tabelare e tarifave dhe ngarkesave të tjera, të shprehura në euro”, pas pikës 01.2.30, shtohet pika e re:

“ 01.2.31.- Kopja e kontratës dhe e pagesave për rregullimin e tokës
ndërtimore 3,00 €”

Neni 2

Pas pikës 06.3.2, shtohen dy pika të reja:

“ 06.3.3. – Gropimet e tokës urbane dhe të rrugëve për ndërtimin e kanalizimit kabllovik energjetik, të postë-telekomunikacionit, për shtrirjen e lirë të kabllove për tension të ndryshëm 04kV, 10kV etj., të kabllove optike të postëtelekomunikacionit me dimensione të ndryshme, për ndërtimin e rrjetit energjetik dhe telefonik ajëror dhe objekteve të tjera të ngjashme, paguhet:

Tarifa sipas zonave:

Zona I	40,00 €
Zona II	35,00 €
Zona III	30,00 €
Zona IV	25,00 €

06.3.4. Për vendosjen e transmetuesve (antenave), me frekuenca të ndryshme, për nevojat e telefonisë mobile, të telefonisë fikse, të televizionit, e të tjera të ngjashme, paguhet:

Tarifa sipas zonave:

Zona I	2‰ (promila)
Zona II	1,50 ‰ (promila)
Zona III	1,30 ‰ (promila)
Zona IV	1,00 ‰ (promila)

nga vlera parallogaritare e objektit.”

Neni 3

Pas pikës 10.1, shtohet pika e re:

“10.1.1. – Për vendosjen e foltoreve telefonike:

Tarifa mujore për foltore 20,00 €”

Neni 4

Pas pikës 10.2.2, shtohen (katër) pika të reja:

“ 10.2.3. – Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e automjetit lëvizës për shitjen e ushqimit të shpejtë.

Tarifa mujore 50,00 €

10.2.4. – Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e tendave (çadrave) të hapura lëvizëse me mekanizëm.

Tarifa vjetore për tendë8,00 €/m²

10.2.5. – Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e lojërave të fëmijëve:

Tarifa mujore3,00 €/m²

10.2.6. – Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e gjeneratorëve statik

Tarifa mujore sipas zonave:

Zona I20,00 €/m²

Zona II15,00 €/m²

Zona III10,00 €/m²

Neni 5

Pas pikës 10.7.2.2, shtohet pika e re:

“ 10.7.2.3. – Vendosja e ekraneve elektronike reklamuese

Tarifa vjetore325,00 €/m².”

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01 nr. _____ , datë _____ 2005.

K R Y E T A R I
Ismet Beqiri